

KËRKIME GJUHËSORE

Eglantina SHTYLLA

SHUMËSI EMËRTIMESH APO SINONIMI DIALEKTORE

Kohët e fundit (në vitin 2010) ka dalë nga shtypi vepra “Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht, latinisht-shqip”, i hartuar nga prof. Xhevat Lloshi. Vepra u mungonte jo vetëm specialistëve leksikografë, por edhe një rrethi më të gjerë përdoruesish. Hartimi i këtij fjalori ka qenë një nga objektivat e kryehershme të këtij gjuhëtari. Shtysën e ka marrë nga puna me fjalën shqipe, por edhe sepse në gjuhën tonë ka mijëra e mijëra emërtime për kafshë dhe bimë. Sipas prof. Xh. Lloshi, “trevat shqiptare në perëndim të Ballkanit, ndonëse nuk përbëjnë një sipërfaqe shumë të madhe, përmbajnë afër 40 % të bimësisë dhe të kafshëve të Evropës, falë kjo larmisë gjeografike dhe klimatike të kësaj zone. Është një pasuri e dukshme për një sipërfaqe kaq të vogël, është një pasuri që na e ka falur natyra. Gjuha shqipe i është përgjigjur me mundësitë e veta kësaj pasurie, duke krijuar emërtimet e nevojshme.”¹ Mjafton të bëjmë me dije se vetëm me fjalën bar kemi 454 emërtime të standardizuara, të përpunuara e të dhëna në dy gjuhë, pa llogaritur këtu me qindra e qindra emërtime të tjera që jetojnë në të folme të ndryshme të trojeve shqipfolëse dhe që e çojnë numrin e përgjithshme të këtij grupi tematik me rreth 1000 njësi, d.m.th., formojnë një fjalorth më vete.

Siç shihet dhe nga titulli, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht, latinisht-shqip*, vepra është kurorëzim i punës dhe i përpjekjeve disavjeçare të hartuesit për të sjellë nga bota shqiptare shumësinë e emërtimeve nga biologji (botanikë dhe zoologji), emërtime që kanë hyrë në përdorim nga dy burime: ose të krijuar nga shqipja a me brumin e shqipes, ose të huazuara.

Kafshët dhe bimët që rriten në të gjithë hapësirën shqiptare dhe që janë jetike për banorët e kësaj hapësire dalin me shumë emërtime, sidomos kur u drejtohem emërtimeve në dialekte. Numri i madh i këtyre emërtimeve, brenda një termi të përgjithshëm, ka qenë dhe shkaku për t’u ndalur në një problem gjuhësor: në këtë rast kemi shumë emërtime për një realie (kafshë apo bimë) apo kemi shumë sinonime dialektore që lidhen me këtë realie dhe e shënojnë atë duke u mbështetur nga këndvështrime të ndryshme?

Mendojmë se është me vend të rimarrim këtu shkurt konceptin për sinoniminë. Ajo është një nga relacionet leksiko-semantike më të njohur në gjuhësi, d.m.th., jo vetëm te ne por dhe në atë botërore. Përgjithësisht pranohet se sinonimia bën pjesë te relacionet e pakushtëzuara semantiksht, njësitë që hyjnë në marrëdhënie sinonimie, janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë a të afërt, ose në gjuhë ekzistojnë “dy-tre a më shumë fjalë që shënojnë të njëjtin send, të njëjtin tipar, të njëjtin veprim apo të njëjtën dukuri”².


¹ Xh. Lloshi, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip - latinisht, latinisht -shqip*, Shkup, 2010, f. 5.

² J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 153.

EGLANTINA SHTYLLA

Me sinoniminë në gjuhën shqipe është marrë shumë edhe studiuesja kosovare Sh. Islamaj. Në punimin monografik “Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe”, ajo thotë se “sinonimet janë fjalë me kuptim të njëjtë apo fjalë të ndryshme për nga përbërja tingullore dhe nga origjina, por të afërta apo të njëjta për nga kuptimi” apo “sinonime konsiderohen fjalët të cilat kanë një domethënie të njëjtë leksikore dhe dallohen vetëm nga nuancat kuptimore, nga ngjyrat ekspresive dhe nga përkatësia e njëres apo e tjetres sferë stilistikore, që kanë deri diku një përputhshmëri të plotë a të pjesshme, kështu që në kontekste të caktuara janë të zëvendësueshme në mes vete”³.

Raporti i sinonimisë leksikore, midis dy fjalëve, mund të paraqitet skematikisht si më poshtë:



Sipas prof. R. Memushaj, në qoftë se dy fjalë, A dhe B, të paraqitura secila në formë rrethi, *përputhen në pjesën më të madhe*, (pjesa e përbashkët tregon semat e njëjta), atëherë ato janë *sinonime me kuptime të afërta*. Kur rrathët *përputhen plotësisht*, kemi sinonime *me kuptime të njëjta*.⁴ Sinonimet e para quhen të paplota, kurse sinonimet e dyta quhen sinonime të plota. Në *Fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe* përgjithësisht pranohet që sinonimet më të shumta janë fjalë të afërta nga kuptimi, që do të thotë se kanë edhe njëfarë dallimi ndërmjet tyre, sado i imët qoftë ai. Pranoen katër dallime ose elemente dalluese: *nuanca kuptimore*, *ngjyrimi stilistik -emocionues*, *aftësia për të krijuar fjalë të reja dhe për t'u lidhur me fjalë të tjera në togfjalësha* (fjalëformimi e sintagmatika) dhe *hapësira gjuhësore e grupimit dhe e përdorimit* (paradigmatika).⁵ Për të përcaktuar nëse dy fjalë janë sinonime, na ndihmojnë shumë fjalorët shpjegues, sepse duke u mbështetur tek ata, me shumë lehtësi bëjmë krahasimin e strukturave kuptimore të këtyre fjalëve, duke nxjerr në pah vetë kuptimet leksikore të fjalëve (duke i vënë në opozicion).

Metoda e opozicionit semantik mund të ndiqet edhe në fjalorët dygjuhësh, sepse vështrohen karakteristikat stilistike, ligjërimore, emocionuese, shprehëse, paradigmatiche e sintagmatike të fjalëve. Kjo ka rëndësi shumë të madhe për fjalorët dy gjuhësh të leksikut të përgjithshëm. Në këta fjalorë “fjalës së gjuhës A i duhet gjetur në gjuhën B barasvlerësja më e plotë në të gjitha elementet

³ Sh. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985, f. 27.

⁴ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2010, f. 163.

⁵ Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, f. 8.

SHUMËSI EMËRTIMESH APO SINONIMI DIALEKTORE

që përmendëm, për të ruajtur jo vetëm barazinë semantike, por edhe karakteristikën ligjërimore a stilistike, mbishtresimet emocionuese e shprehëse etj.”⁶

Por në përdorim ka fjalorë jo vetëm fjalësh të leksikut të përgjithshëm, por edhe termash. Dihet se tipari kryesor i një termi është njëkuptimshmëria (monosemantizmi), si dhe mënjanimi në skajshmëri i marrëdhënies sinonimike. Në *Fjalorin e emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip - latinisht, latinisht – shqip*, autori i tij, studiuesi Xhevat Lloshi tërheq vëmendjen për kufijtë e sinonimisë, sidomos për sinoniminë që ka të bëjë me emërtimet e bimëve e të kafshëve. Sipas tij *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*, 2004, vjen ndesh me mënyrën se si trajtohen emërtimet e këtij lloji në fjalorët e gjuhëve evropiane... Sipas tij “ka qindra raste, në të cilat është përbuzur përvoja gjuhësore shqiptare për të bërë dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të bimëve e të kafshëve. Te fjala *dushk* janë renditur si një çerdhe sinonimike *lis, qarr, qarrbutë, qarrazi, qarrucë, bugër, bung, bungëbutë, bungëkeqe, bungëkuqe, bungëleshe, butishtë, shparth, prrall, përnar, ngasje, ilqe, valanidh, rrënjë, meçkadin.*”⁷

Në se mbështetemi te pikëpamja e prof. Xhevat Lloshit për sinoniminë në emërtimet terminologjike apo në emërtimet e nomenklaturës, emërtimet e mësipërme dalin si një grup njësisish që kanë mëvetësi ndaj njëra tjetrës, *duke formuar shumësi emërtimesh dhe jo grup a varg sinonimik*. Sepse ato dalin si emërtime të veçanta, në të folme të veçanta. Ato janë grumbulluar nga studiuesi si lloje emërtimesh, kurse sinonime do të kemi atëherë kur në të njëjtin areal gjuhësor të përdroreshin dy ose më shumë emërtime për të njëjtin nocion a të njëjtin realie. Kështu njësitë e mëposhtme, gjithnjë sipas prof. Xh. Lloshit nuk janë sinonime. P.sh., në fjalor jepet termi **aguliçja**, me emërtimet në latinisht *Primula veris, P. vulgaris, P. acaulis, P. grandiflora* &: si dhe emërtimet në të folme të ndryshme, si *gorolulja, gjerdani, lakërishia, lejthici, lulekaçja, lulja gjastëgishtëshe, lulja këmbëgjatë, lulja gjastëgishtëshe, lulja këmbësutë, lulja e lajthisë, lulja lejthiçe, lulja e plakut, lulja e pranverës, lulja e qengjit, lulja rremaçoke, lulja shelege, myzhdeja e pranverës, poleska, salepi, zgorofeta*.

Por prof. J. Thomai kur flet për klasifikimin e sinonimeve të tipit fjalë të mbarë gjuhës a të standardit // fjalë dialektore (krahinore), pranon si sinonime edhe domate - kumbullore, gjel - kokosh, patate – kërtolla etj. Po kështu ai në tipin fjalë dialektore (krahinore) // fjalë dialektore (krahinore) ai pranon si sinonime edhe: kaposh - kokosh, mollatarta – kumbullore. Për grupin e parë ky studiues shprehet se në këto raste ka një fjalë më të përgjithshme që është pranuar si normë, kurse për grupin e dytë pranon se sinonimet dialektore qëndrojnë jashtë kufijve të leksikut të standardit.

Edhe prof. Rahmi Memushaj, është në një mendim kur thotë se “kur dy a më shumë fjalë mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë në të

⁶ Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, f. 9-10.

⁷ Xh. Lloshi, Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip - latinisht, latinisht -shqip, Shkup, 2010, f. 5.

EGLANTINA SHTYLLA

njëtin kontekst pa sjellë ndryshime kuptimi, kemi sinonime të *plota*. Këto më shpesh quhen *sinonime absolute* ose *dublete leksikore*. Që dy njësi leksikore të jenë sinonime absolute, duhet të kenë të njëjtën përndarje. Kjo do të thotë se sinonimet absolute janë fjalë me vëllim kuptimor të barabartë. Si rregull, ato paraqiten në çifte, më rrallë edhe në vargje, dhe u takojnë sistemeve të ndryshme leksikore. Të tilla janë çiftet sinonimike fjalë shqipe – fjalë e huaj..., fjalë dialektore – fjalë e gjuhës standarde: *kërtolla* për *patate*, *kallamboq* për *misër* etj.

Atëherë kemi shumësi emërtimesh apo sinonimi? A mund të ketë diversitet terminologjik në fushën e dertimeve të kafshëve dhe të bimëve? Mendojmë se kjo varet nga pikëvështrimi. Do të pranohet diversiteti terminologjik në formën e sinonimisë (edhe pse sinonimia nuk pëlqehet në terminologji) kur termat sinonimë përputhen plotësisht me konceptet. Por kjo mendojmë se nuk është e mjaftueshme. Do të pranojmë se shumësia e emërtimeve për një koncept (bimë apo kafshë) duhet të vendoset në një korrelacion jashtë fushës ku ato ekzistojnë. Kështu nëse shumësinë e emërtimeve në të folme të ndryshme e shohim në marrëdhënie me termin që është normativ, që është pasqyruar edhe në fjalorë shpjegues kombëtarë, atëherë krijohet sinonimia fjalë e shqipes standarde / fjalë dialektore.

Fjala vjen në grupin e emërtimeve të mëposhtme termi **akacia** (lat.) *Robinia pseudacacia*, *Acacia pseudorobinia* hyn në marrëdhënie me emërtimet terma *akacia e bardhë*, *akacia e rreme*, *bagremi*, *çalia*, *çelia*, *driza e butë*, *druri i shitimit*, *ferra e detit*, *ferra e jashtme*, *ferrecka*, *kaça*, *kaçeza*, *kapa*, *makazja*, *robinja*, *rogovecka*, *sallgami*, *sollkëmi*.

Sinonimia mund të vendoset ndërmjet një emërtimi të pathjeshtë (emërtimi togfjalësh) si **ajdësi i alpeve** (*Laburnum alpinum*, *Cytisus alpine*) dhe emërtimeve të tjera që mund të jenë fjalë të parme të prejardhura, të përbëra apo dhe emërtimi të pathjeshta, si *ajësi*, *arzëni*, *arrëza*, *ashkla*, *bobosfenti*, *busufrati*, *donosfrati*, *drokthi i alpeve*, *hithka*, *lini*, *perushani*, *vojësi*, *vojmësi*, *zgorofeta*.

Sinonimia mund të vendoset midis një fjale që nuk është shqip me fjalë të tjera, nga të cilat shumica mund të jenë fjalë të huaja, si **çiçibanozi** (*Ceratonia siliqua*) *batha e detit*, *çiçibunia*, *çoçobanuzja*, *harupa*, *karumba*, *kokoreci i butë*, *ksilloja*, *ksilloqera*, *ksoqerëza*, *ksoqerja*, *kundrudha*, *rogovecka*, *rragaça*, *sqilloja*, *xixibanozi*, *xhixhibanozi*.

Profesor Xh. Lloshi, edhe pse nuk pranon sinonimi të mirëfilltë, si sinonimi e plotë (dublete leksikore) në fjalor ndodh e kundërta: ai i referon (me shigjetë) një pjesë të madhe të emërtimeve të bimëve apo të kafshëve te një fjalë tjetër sinonime që shqipja e ka në përdorim:

arneni i bardhë —> *arneni*

arneni i kuq —> *rrobulli arni 1.* —> *rrobulli; 2.* —> *arneni*

arni i bardhë —> *arneni*

arqita —> *shelgu i butë*

arsllani —> *luani*

artemisja —> *pelini*

artigoka —> *angjinarija*

SHUMËSI EMËRTIMESH APO SINONIMI DIALEKTORE

artini 1. —> *rrobulli*; 2. —> *vgjeri*

artini i bardhë —> *arneni*

artini i keq —> *rrobulli*

artini i kuq —> *pisha e kuqe*

artiri —> *rrobulli*

Gjithashtu, nëse një pjesë e emërtimeve ose të gjitha emërtimet për një bimë apo kafshë, janë të njohura në një të folme të veçantë, atëherë, fjala më e njohur hyn në marrëdhënie sinonimie me fjalët e tjera. Por kjo dukuri, nëqoftëse ne mbështetemi te *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip - latinisht, latinisht -shqip*, nuk mund të ndodhë, sepse autori i veprës ka mbledhur lëndë ngë burime të ndryshme për areale gjuhësore të ndryshme. Nëse e hamendësojmë këtë dukuri te grupi në vazhdim i këtyre emërtimeve, mund të ndodh të kemi sinoniminë fjalë dialektore / fjalë dialektore për shumë njësi: *arneni* (*Pinus peuce, P. excelsa* &) *ardhënia*, *arneni i bardhë*, *arni*, *arni i bardhë*, *artini i bardhë*, *errla*, *keqina*, *mëkishi*, *mëlika*, *mërlika*, *molika*, *orrla*, *pisha ballkanike*, *rrneni*, *rrobulli i bardhë*.

Emërtimet në fjalor, për pasojë edhe fjalët që hyjnë në marrëdhënie sinonimie mund t' i kemi në dy grupe:

a. Emërtime për bimë: **rrushkulli** *Ruscus aculeatus* &: *bari i hidhet*, *bobokuqja*, *ferra çaliqe*, *garcafeci*, *gargafeci*, *kokruqja*, *koqekuqja*, *lulekuqja*, *molla e lepurit*, *mreti i egër*, *mretja e egër*, *ngjitësi*, *përceza*, *përcëllaku*, *përcja*, *ruspa*, *rrushku*, *shurrëkuqja*, *therelepuri*, *therepeli*, *therpela*, *therra e lepurit*, *therra e miut*, *therim*.

uthullishtja *Rumex acetosella*, *Oxalis acetosella* &: *bari i ikballit*, *lëpjeta e lepurit*, *lulja e ikballit*, *sullupjesa*, *trefletëshi*, *tharbëtoja*, *tharbëtusha*, *tharbitica*, *tharbtusha*, *thartorja*, *uthulla e egër*, *uthulla e gjelit*, *uthulla e lepurit*, *uthullaçi*, *uthullarja*, *uthullica*, *uthullima*, *uthullinka*, *uthullniqja*.

trëndafili i egër *Rosa canina* &: *bythëkroma*, *drandofilli i bjeshkëve*, *ferra e bardhë*, *ferrëbardha*, *ferrëkaçja*, *kaça*, *kaça e bardhë*, *kaçibardha*, *kaçja*, *kërmëbythja*, *kërrombythja*, *kroca*, *kroma*, *kromëbythja*, *lulekaçja*, *rodhostani i egër*, *skromëza*, *trëndafili i bjeshkëve*, *trëndafili i qenit*, *trëndafiloku*, *therra e kuqe*.

ushqera *Echium vulgare* &: *bari i boçes*, *bari i nepërkës*, *bari i rrebullit*, *gjuha e nepërkës*, *lulja e bletës*, *lulja gjuhë gjarpri*, *lulja sheqere*, *lulja sherbete*, *lulja e therrës*, *sirma e qyqes*, *shaljarja*, *ushqerëza*

rrushi i qyqes 1. *Sedum acre* &: *bari fjettrashë*, *bari fletëtrashë*, *bari i qetes*, *bari i udhës*, *bari i urdhjes*, *kreza*, *e paemra*, *rrushqyqja*, *rrushqyqja e athët*, *thonjtë e qetes*, *urdhja*, *urthja*, *ureza*, *urzeliku*, *urrëza rrushi i qyqes i madh* 2. *Sedum telephium*, *S. maximum* &: *babaniku*, *bari i tamblit*, *lulja e koftarit*, *lulja pafkë*, *lulja e veshit*, *tambëlçaku*, *veshi i gomarit*.

b. Emërtime për kafshë: **ujku** *Canis lupus* &: *bisha*, *bisha e pagojë*, *bishtgjati*, *bishtdrugani*, *egërsira*, *egërtia*, *gojëfarkuemi*, *gojëkyçuri*, *gojëlidhuri*, *gojëmbërthyeri*, *gojëmylluri*, *gojëmshelmi*, *gojëngriri*, *gojëqepuri*, *gojëthati*, *gojëzëni*, *këmbëlehti*, *kumbara i natës*, *largneshi*, *i*

EGLANTINA SHTYLLA

pagoji, i papjesi, i paqeni, qafëtrashi, qafëthyeri, sendi i malit, shpendi, ujku i hirtë, uluritësi, ungri, veshcurri, zdrugoni.

Si përfundim, në të folmet e gjuhës shqipe ka me mijëra emërtime për mijëra bimë dhe kafshë që gjenden në Shqipëri. Por edhe për një bimë ose kafshë mund të kemi disa, madje dhjetëra emërtime që lidhen me të folme të ndryshme dhe që njihen nga një numër i ndryshëm njerëzish. Në këtë shumësi emërtimeve lehtësisht mund të shihen edhe marrëdhëniet sinonimike ndërmjet tyre, sidomos kur njëra ose disa prej këtyre janë me shtrirje shumë të gjerë gjeografike dhe me denduri të madhe përdorimi.